

## GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

**Pml.Kzz 91/2015**

**(P. Nr. 98/2014 Gjykata Themelore në Mitrovicë)**

**(PN1 496/2014 Gjykata e Apelit)**

Data:

**14 maj 2015**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova (kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese), Gjyqtarja e EULEX-it Esma Erterzi dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Sali Toplica i anëtarë të kolegjit, dhe Zyrtarja ligjore e EULEX-it Elise Svenkerud Thoen si procesmbajtëse, në lëndën penale P. Nr. 98/2014 të Gjykatës Themelore në kundër:

**NV;**

*I akuzuar për Vrasje të rëndë* në formë të privimit të personit tjetër nga jeta për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 179 (1.10) lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) gjithashtu e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale edhe sipas nenit 30 paragrafit 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenin 22 të KP RSFJ-së;

**Vrasje të rëndë në tentativë** në formë të privimit të personit tjetër nga jeta për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje që ka rezultuar në lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 179 (1.10) dhe nenit 189 (2.1 dhe 5) në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPK-së gjithashtu e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale edhe sipas nenit 30 paragrafit 2 dhe nenit 38 paragrafit 2 të LP KSAK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

**Vrasje të rëndë në tentativë** në formë të privimit të personit tjetër nga jeta për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 179 (1.10) në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPK-së gjithashtu e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale edhe sipas nenit 30 paragrafit 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

*Duke vepruar lidhur me Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë* të paraqitur nga i pandehuri NV më 6 prill 2015 kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 98/2014 të datës 19 mars 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1. 496/2015 të datës 27 mars 2015 mbi vazhdimin dhe konfirmimin e paraburgimit kundër të pandehurit deri më 19 maj 2015;

*Pas shqyrtimit të përgjigjes së paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Shtetit më 27 prill 2015;*

*Pas këshillimit dhe votimit më 14 maj 2015.*

*Sipas nenit 418 dhe neneve 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)*

*lëshon këtë:*

---

## AKTGJYKIM

---

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri NV më 6 prill 2015 kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 98/2014 të datës 19 mars 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1. 496/2015 të datës 27 mars 2015 mbi vazhdimin dhe konfirmimin e paraburgimit kundër të pandehurit deri më 19 maj 2015, refuzohet si e pabazuar.**

### ARSYETIM

#### **1. Historia e procedurës**

1.1 Hetimi penal në këtë lëndë ka filluar më 21 shkurt 2013 dhe me vendimin e Prokurorit Special të datës 10 mars 2014 është zgjeruar ndaj të pandehurit (dhe të tjerëve).

1.2 Aktakuza është ngritur më 11 gusht 2014. Më 19 gusht 2014, kryetari i trupit gjykues ka caktuar paraburgimin prej një muaji kundër të pandehurit (dhe të tjerëve). Shqyrtimi fillestar është mbajtur më 26 gusht 2014, dhe është lëshuar urdhri për trajtimin mjekësor të të pandehurit si dhe është kërkuar raporti mbi rezultatin e ekzaminimit.

1.3 Më 25 shtator 2014, raporti është pranuar nga gjykata, dhe është kërkuar mendimi i mëtutjeshëm. Në ndërkohë, më 10 shtator 2014 avokati mbrojtës Faruk Korenica ka paraqitur kërkesë duke kërkuar nga kryetari i trupit gjykues që të zëvendësojë paraburgimin me masën e arrestit shtëpiak mbi bazën e gjendjes shëndetësore të dobët të të pandehurit. Kjo kërkesë është refuzuar më 19 shtator 2014.

1.4 Më 13 nëntor 2014, i pandehuri ka paraqitur kërkesë sipas nenit 192 (5) të KPP-së duke kontestuar ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit mbi bazën e gjendjes së tij shëndetësore aktuale. Kjo kërkesë është refuzuar më 18 nëntor 2014, duke e vazhduar paraburgimin kundër të pandehurit. Ky aktvendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 22 nëntor 2014.

1.5 I pandehuri ka paraqitur një parashtresë tjetër lidhur me gjendjen e tij shëndetësore më 1 dhjetor 2014, duke kërkuar nga kryetari i turpit gjykues që ta vizitojë atë në paraburgim. Kjo kërkesë është refuzuar në shkresën e dërguar të pandehurit të datës 16 dhjetor 2014.

1.6 Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur më 18 dhjetor 2014.

1.7 Më 22 dhjetor 2014, avokati mbrojtës Faruk Korenica ka paraqitur kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit duke iu referuar, inter alia, problemeve shëndetësore të të pandehurit dhe duke kërkuar që ai të lirohet apo t'i caktohet një masë më e butë. Për më tepër, më 15 janar 2015 avokati mbrojtës Žarko Gajić ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e paraburgimit. Të dy kërkesat janë refuzuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin e saj të datës 16 janar 2015 me të cilin gjithashtu është vazhduar paraburgimi kundër të pandehurit deri më 19 mars 2015. Ky aktvendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 23 janar 2015.

1.8 Më 19 mars, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj të tjerë, prej 19 marsit deri më 19 maj 2015. Aktvendimi është ankimuar nga avokati mbrojtës Faruk Korenica si dhe nga i pandehuri. Gjykata e Apelit ka refuzuar të dy ankesat me aktvendimin e saj të datës 27 mars 2015 si të pabazuara dhe ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore. I pandehuri ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtyre dy aktvendimeve të fundit të lëshuara nga Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe Gjykata e Apelit përkatësisht më 6 prill 2015.

## **2. Parashtresat e palëve**

### Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri NV:

2.1. Më 6 prill 2015, i pandehuri NV ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 98/2014 të datës 19 mars 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1. 496/2015 të datës 27 mars 2015 përkatësisht mbi vazhdimin dhe konfirmimin e paraburgimit kundër të pandehurit deri më 19 maj 2015.

2.2 I pandehuri kërkesën e tij e bazon në shkelje të ligjit penal dhe në shkelje substanciale të procedurës penale. I pandehuri pretendon *inter alia* se prokuroria ka dështuar që t'i përmbahet dispozitave të kodit të procedurës penale të RSFJ-së neneve 400, 402, 403, 406 dhe 407 për faktin se nuk është paraqitur asnjë kërkesë për rihapjen e procedurës penale para 11 gushtit 2014 kur është ngritur aktakuza përkundër faktit që hetimi kundër tij ishte ndërprerë më në vitin 2002. Më tutje, se kushtet për rihapjen e procedurës penale siç janë përcaktuar me nenin 423 të KPP-së nuk janë përmbushur pasi që ai asnjëherë nuk është akuzuar nga UNMIK-u. Përveç kësaj, as i pandehuri e as prokurori nuk kanë paraqitur kërkesë për rigjykim sipas nenit 424 të KPP-së dhe

rrjedhimisht një kërkesë e tillë asnjëherë nuk është pranuar nga Gjykata Themelore siç është përcaktuar me nenet 426 – 428 të KPP-së.

2.3 I pandehuri, gjithashtu thekson se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë injoruar dispozitat e lartpërmendura të kodit të procedurës penale dhe gabimisht kanë shqyrtuar në parimi *Ne bis in idem* është i zbatueshëm që është jo-relevante në lëndën në fjalë. Sidoqoftë, ai thekson se kjo lëndë kundër tij tashmë është vendosur në vitin 2002 kur kolegji i gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka gjetur se ka pasur arsye të pamjaftueshme që të urdhërohet hetimi kundër të pandehurit dhe për këtë arsye përbën *res judicata*.

2.4 Përfundimisht, i pandehuri pohon se nuk ka dyshim të bazuar se ai ka kryer veprat e pretenduara penale, e as nuk ekziston rreziku i arratisjes apo rreziku i manipulimit të provave dhe për këtë arsye ka shkelje të KPP-së nenit 193 (2) cf. Nenet 187 të KPP-së. Ai, gjithashtu thekson se gjykatat nuk kanë shqyrtuar gjendjen e tij shëndetësore gjatë vazhdimit të paraburgimit në aktvendimet e lartpërmendura.

#### Përgjigja e Zyrës së Prokurorit të Shtetit

2.5 Prokurori i Shtetit pajtohet me arsyetimin e aktvendimeve të kontestuara dhe gjen se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pa merita. Ai vëren se shumica e pretendimeve të të pandehurit tashmë janë prezantuar si bazë e ankesës dhe janë refuzuar nga Gjykata e Apelit. Mbi këtë bazë, Prokurori i Shtetit i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të vërtetojë aktvendimet e kontestuara në tërësi.

### **3. Kompetencat e kolegjit**

3.1 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (tani e tutje “ligji omnibus”), i miratuar më 23 prill 2014 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 30 maj 2014 *inter alia* i cili ndryshon Ligjin Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tani e tutje ‘*ligji mbi kompetencat*’) rregullon juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it i cili ka të bëjë me kompetencat e gjykatës.

3.2 Kolegji njëzëri ka vendosur se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga të pandehurit dhe avokati mbrojtës duhet të konsiderohen si “rast në proces” sipas nenit 1.A të ligjit omnibus, dhe prandaj gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca në këtë lëndë.

### **4. Gjetjet e kolegjit**

#### A. Gjetjet e përgjithshme

4.1 Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga të pandehurit dhe avokati mbrojtës dhe përgjigja e Prokurorit të Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit kohor.

4.2 I pandehuri ka ngritur një numër të madh çështjesh. Sidoqoftë, Gjykata Supreme vëren se shumica e parashtrësive janë vetëm përsëritje e çështjeve të cilat janë ngritur nga mbrojtja kundër kërkesave të prokurorisë dhe aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë mbi caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit të cilat janë shqyrtuar me kujdes dhe në hollësi nga Gjykata e Apelit. Fatkeqësisht, është një tendencë e përhapur gjerësisht në mesin e shumë avokatëve mbrojtës dhe të pandehurve që mundohen ta përdorin kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si ankesë të dytë, e që nuk do të duhej të ishte.

4.3 Argumentet e paraqitura nga i pandehuri mund të ndahen në dy kategori; argumentet që kanë të bëjnë me vendimin e lëshuar nga kolegji i gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë të datës 3 gusht 2002 dhe argumentet që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të nenit 193 (2) cf. nenit 187 të KPP-së.

#### B. Argumentet e prezantuara nga i pandehuri që kanë të bëjnë me vendimin e lëshuar nga kolegji i gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë të datës 3 gusht 2002

4.4. Sipas vendimit me numër të referencës HEP Nr. 139/2002, PP Nr. 1013-1002, një panel i gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, më 3 gusht 2002 ka vendosur se ka pasur arsye të pamjaftueshme për të urdhëruar një hetim kundër të pandehurit. Gjykata Supreme fillimisht vëren se ky vendim nuk mund të verifikohet, pasi që ai nuk është gjetur në vendin ku është lëshuar. Sidoqoftë, edhe në qoftë se dokumenti është i vërtetë, argumentet e ngritura nga i pandehuri në këtë drejtim janë të pabazuara.

4.5 Së pari, dispozitat në kodin e procedurës penale të RSFJ-së siç u është referuar i pandehuri nuk janë të zbatueshme. Kapitulli XXXVIII i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i datës 13 dhjetor 2012 i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 përfshinë dispozitat kalimtare të ligjit. Sipas nenit 539, “*çdo procedurë penale e filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi duhet të jetë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë Kod*”.

4.6 Hetimi penal në këtë rast është iniciuar më 21 shkurt 2013 dhe është zgjeruar kundër të pandehurit (dhe të tjerëve) me vendim të Prokurorisë Speciale të datës 10 mars 2014. Prandaj, është e qartë se KPP-ja është i zbatueshëm.

4.7 Së dyti, dispozitat e përmendura nga i pandehuri në KPP janë pa merita. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë është një vendim për të mos urdhëruar fillimin e hetimeve. Prandaj, nuk ishte as lirim, e as vendim për hedhjen poshtë të procedurës penale nga një aktvendim i formës së prerë cf. neni 422 i KPP-së, ose një vendim për ndërprerjen e procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë. Gjykata Supreme, për më tepër e ka krahasuar vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 3 gusht 2002 me aktakuzën e tanishme kundër të pandehurit, dhe është e qartë se faktet e përshkruara në dy dokumentet janë plotësisht të ndryshme, pasi që rasti i parë është shumë më i gjerë sesa rasti aktual. Si i tillë rasti kundër të pandehurit nuk mund të konsiderohet si një ri-gjykim dhe nuk shkakton parimin e *ne bis in idem*

4.8 Përveç kësaj, pasi që vendim i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 3 gusht 2002 ishte vetëm një vendim për të mos filluar hetime dhe jo një vendim i formës së prerë kundër të pandehurit, ai nuk mund të përbëjë *res judicata* edhe në qoftë se çështja dhe palët e rastit ka qenë e njëjta, e që nuk janë.

#### C. Argumentet e prezantuara nga i pandehuri që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të nenit 193 (2) cf. nenit 187 të KPP-së

4.9 I pandehuri pohon se nuk ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprat e pretenduara penale, e as nuk ekziston rreziku i arratisjes apo rreziku i manipulimit të provave.

4.10 Gjykata Supreme gjen se gjykatat kanë shqyrtuar plotësisht rrethanat e të pandehurit dhe natyrën e veprave të pretenduara në lidhje me ekzistimin e dyshimit të bazuar dhe ekzistimin e rrezikut të arratisjes dhe rrezikut të manipulimit me prova (p.sh. ndikimi në dëshmitarë), dhe se asnjë masë tjetër më e butë nuk do të ishte e mjaftueshme për të eliminuar këto rreziqe.

4.11 Sidoqoftë, Gjykata Supreme vëren se në vendimin e saj të datës 27 mars 2015, kolegji i Gjykatës së Apelit i referohet faktit se dyshimi i bazuar është vërtetuar në një numër rastesh të mëparshme. Edhe pse kjo nuk përbën shkelje të procedurës penale, Gjykata Supreme gjen se ky vendim i Gjykatës së Apelit nuk është vetë-sqarues. Një referencë në "siç është thënë më parë" nuk shpjegon bazën e argumentit në të cilin është mbështetur, që mund ta bëjë të vështirë për të pandehurin që ta kuptojë bazën e vendimit. Edhe pse është përgjegjësi e të pandehurit që të ketë qasje në të gjitha dokumentet e mëparshme të rastit të tij ose të saj, nuk mund të supozojmë se i pandehuri *në fakt* do të ketë qasje në këto dokumente brenda afateve të shkurtra të cilave ai apo ajo i nënshtrohet. Prandaj, Gjykata Supreme këshillon që vendimet në *vetvete* të ofrojnë bazë të mjaftueshme për të pandehurin për t'i kuptuar argumentet plotësisht në mënyrë që të paraqesë një mbrojtje efektive

#### D. Përfundim

4.12 Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje substanciale të kodit penal apo procedurës penale. Si e tillë, kërkesa patjetër duhet të refuzohet.

*Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.*

**Kryetare e kolegjit**

**Procesmbajtëse**

---

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e EULEX-it

**Anëtarët e kolegjit**

---

Esma Ertezi

Gjyqtare e EULEX-it

---

Elise Svenkerud Thoen

Zyrtare ligjore e EULEX-it

---

Sali Toplica

Gjyqtar i Gjykatës Supreme